



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 28.07.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I
HIDROCENTRALEVE “LUMZI” DHE “TUÇI”, ME VENDNDODHJE NË PELLGUN
UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË RROSHIT, BASHKIA PUKË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë koncesionare “M.C. Inerte Lumzi” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Hidrocentraleve “Lumzi” dhe “Tuçi”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Rroshit, Bashkia Pukë”, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “M.C. Inerte Lumzi” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Pukë;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARI I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

